

SHOQËRIA RAJONALE UJËSJETLLËS KANALIZIME KORÇË SH.A.

Nr. ____ Prot

Data 09.09.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje karburante” e ndare sipas loteve:

Loti 1 Gasoil D1

Loti 2 Benzine

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 09100000-0
Karburante

VLERA E FONDIT LIMIT 4.036.850 (katër milion e tridhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e pesëdhjetë) Lekë pa TVSH, e ndarë sipas loteve:

- Vlera limit për lotin e parë për mallin Gazoil D1 është 3.387.000 (tremilion e treqind e tetëdhjetë e shtatë mijë) Lekë pa TVSH.
- Vlera limit për lotin e dytë për mallin benzinë është 649.850 (gjashtëqind e dyzet e nëntë mijë e tetëqind e pesëdhjetë) Lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Korçë Sh.A (UKRK Sh.A), ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

LOTI 1- Gazoil D1

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4, me vlerë 67.740 leke (gjashtëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e dyzet) Leke (2% të vlerës së përllogaritur të kontratës për lotin e parë)
- b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, të ndryshuar nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023, 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së parashikuar në kontratë për secilin nga lotet, pra jo më e vogël se 1.354.800 (një milion e treqind e pesëdhjetë e kater mijë e tetëqind) Lekë per lotin e pare blerje Gazoil D1.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet bazuar ne dispozitat e siperpermendura, ku percaktohet se: “Autoriteti kontraktor per te provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kerkon kopjeve te deklaratave te xhiros vjetore te realizuar nga operatori ekonomik dhe sipas rastit te xhiros qe mbulon kontrata, per nje periudhe maksimumi deri ne 3 (tre) vitet e fundit financiare. Vlera e xhiros minimale vjetore qe u kerkohet operateve ekonomike nuk mund te tejkaloje: (c) 40% te vleres se parashikuar te kontrates, ne procedurat e prokurimit nen kufirin e ulet monetar si dhe siaps parashikimit te nenit 55 te Rregullave te PP”.

“Kërkesa per plotesimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e permbushur nese operatoret ekonomike arrijne vleren e xhiros minimale, ne te pakten nje vit te periudhes se kerkuar nga autoriteti kontraktor”.

Kërkesa e mesiperme është në perpjestim dhe e lidhur ngushte me objektin e kontrates. Ajo i shërben UKRK sh.a per njohjen e gjendjes financiare te operateve ekonomike dhe te mundesise se e tyre per permbushjen me sukses te kontrates. Vlera e xhiros qe kerkohet eshte ne perputhje me vleren e përcaktuar në nenin 43 pika 2.c të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Gjithashtu vlera e kerkuar bazohet në nenin 42 pika 3 te VKM Nr. 285 ku percaktohet se “Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29 te Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, ku percaktohet: “Cdo tatimpagues pergatit deklaraten vjetore te te ardhurave te tatueshme ne formen e percaktuar ne udhezimin e Ministrit te Financave ne zbatim te ketij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaraten vjetore ne organet tatimore brenda dates 31 mars te vitit pasardhes”.

3. Aftesite teknike dhe profesionale:

3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 677.400 (gjatshteqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e katërqind) Lekë pa TVSH (20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate për lotin e parë).

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruarat në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 55, pika 4, b ku përcaktohet shprehimisht, citojmë:

" Për kontratat e mallrave vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. "

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën si më sipër, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar (20% e vlerës per lotin e pare). Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor UKRK SH.A., për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvojave të duhura, që janë në përpjesëtim me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës siç është parashikuar nga AK.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

V. Pili

3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme profesionale për Tregtimin me Pakicë të Karburanteve, Gazit të Lëngshëm të Naftës, për Automjetet, Vajrave Lubrifikante dhe Lëndëve Djegëse për përdorim nga Konsumatorët Fundorë, për gazoilin e per benzinen e kërkuar, lëshuar nga Organi i Qeverisjes Vendore.

(shënim-përcaktimi, nëse parashikohet nga legjislacioni në fuqi, llojin e licencës së nevojshme që lidhet me objektin e prokurimit, si dhe institucionin që lëshon licencën e kërkuar).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar, neni 40, pika 5, gërma a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar, si dhe ligjin Nr. 8450, datë 24.2.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar me ligjin Nr. 71/2014, nenin 14, pika 7, që përcakton se: "Shoqëritë e tregtimit me shumicë kanë të drejtë të furnizojnë, sipas kushteve të licencës përkatëse, rafineritë e naftës, impiantet e përpunimit, shoqëritë e tregtimit me pakicë, të pajisura me licencë tregtimi, mjetet

detare dhe ajrore, si dhe konsumatorët e mëdhenj.”, si dhe neni 1/1, pikat 11, 12, 14,15, përcakton se:

“11. “Shoqëri tregtimi me shumicë” është personi juridik që blen naftë dhe nënproduktet e saj me qëllim shitjeje tek të tretët.

12. “Shoqëri tregtimi me pakice” është personi juridik që blen nënprodukte të naftës, me qëllim shitjeje te personat, që janë konsumatore fundore.

14. “Konsumatorët të mëdhenj” janë personat juridikë që konsumojnë për nevojat e veta nënproduktet e naftës në një sasi jo më pak se 50 m³ në muaj dhe që posedojnë instalime depozitimi të këtyre produkteve.

15. “Konsumator fundor” është personi fizik apo juridik që blen produktet e gatshme për nevojat e veta.”,

Bazuar në këtë ligj, Operatorët ekonomikë duhet të paraqisin Leje (Autorizim) profesionale të tregtimit me pakicë të karburanteve, sepse vetëm leja profesionale e tregtimit me pakicë i jep atyre të drejtën ligjore për të furnizuar UKRK, si një konsumator fundor.

Bazuar në këtë ligj, Operatorët ekonomikë duhet të paraqisin Leje (Autorizim) profesionale të tregtimit me pakicë të karburanteve, sepse vetëm leja profesionale e tregtimit me pakicë i jep atyre të drejtën ligjore për të furnizuar UKRK, si një konsumator fundor.

VKM Nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” të ndryshuar, Kreu II, pika 1 që përcakton:

1. Dhënia e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, e vajrave lubrifikante dhe të njësive të lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, bëhet nga:

a) Ministri që mbulon veprimtarinë e transportit rrugor, kur stacioni i karburanteve do të ndërtohet në autostradë;

b) Organet e qeverisjes vendore, sipas juridiksionit përkatës, në rastet kur stacionet e shitjes së karburanteve, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të karburanteve për automjete, gazit të lëngshëm e vajrave lubrifikante dhe të njësive të shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, do të ndërtohen në territoret e tjera.”

(shënim- përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse të furnizimit, ose nëse është rasti të prodhimit të mallrave objekt prokurimi, që lidhet me objektin e kontratës së prokuruar).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

V. Pili

3.3. Raport testimi, për cilësinë e gazoilit, në përputhje me specifikimet teknike të DT, lëshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit/ Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI).

Argumentim: Ky kriter është vendosur nga ana e AK në zbatim të kërkesave që përcakton ligji nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ligji Nr. 8450, datë 24.02.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM Nr.147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzene dhe diesel” si dhe VKM Nr. 491, date 19.07.2017 “Per percaktimin e rregullave, te kushteve teknike dhe normave te

mirembajtjes se instalimeve nen presion, qe sherbejne per perpunimin, transportimin, depozitim dhe tregtimin e naftes, te gazit dhe nenprodukteve te tyre”, kreu V.

Plotësimi i këtij kriteri garanton ekzekutimin e objektit të kontratës në përputhje me specifikimet teknike të DT.

3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga Organet e Miratuara të Vleresimit të Konformitetit/ISHTI, që subjekti ka tregtuar karburante sipas standarteve të legjislacionit shqiptar dhe nuk ka patur penalitete për shkelje të cilësisë të karburantit për vitin 2024.

Argumentim: Ky kriter është vendosur nga ana e AK në zbatim të kërkesave që përcakton ligji nr.8450, datë 24.02.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM Nr. 970, datë 2.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” të ndryshuar, VKM Nr.147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzine dhe diesel”.

Plotësimi i këtij kriteri garanton zbatimin e kontratës gjatë periudhës së zbatimit duke treguar që OE ofertues në aktivitetin e tij zbaton rregullat dhe ligjet në fuqi.

3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të dorëzojë një deklaratë/listë të stacioneve të shitjes (shpërndarjes) të gazoilit, me adresat e tyre, e cila të vërtetojë që ofertuesi të ketë stacione shitje të gazoilit në rajonin ku ushtron veprimtarinë e saj Shoqëria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Korçë sh.a (në Korçë, aksin Korçë - Ersekë, në aksin Korçë – Bilisht dhe në aksin Korçë - Maliq) si dhe në aksin Korçë - Tiranë.

Argumentim: Në bazë të nenit 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që disponojnë stacione të shitjes të gazoilit në akset si me sipër.

Disponimi i stacioneve të tregtimit të karburantit në akset si me sipër përmendur kërkohet për shkak se Korça, Erseka, Bilishti e Maliqi janë vendet e ushtrimit të aktivitetit të AK Shoqërisë Rajonale Ujesjellës Kanalizime Korçë Sh.A .

Disponimi i stacioneve të tregtimit të karburantit në aksin Korçë - Tiranë kërkohet për shkak se punonjësit e AK kryejnë në Tiranë, lëvizje me automjete për arsye pune, si takime, mbledhje, seminare, trajnime etj, me ditë qëndrimi më shumë se një ditë dhe mund të lindë nevoja për furnizim me karburant me kartën elektronike, në stacionet e tregtimit të karburantit.

V.Pili

3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë marrjen përsipër të furnizimit me karta elektronike sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

Argumentim: Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar neni 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që disponojnë stacionet e shitjes të gazoilit të kërkuara si dhe mund të kryejnë furnizimin me karta elektronike, për të përmbushur kontratën, të nevojshme këto për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Konvertimi i sasisë së litrave me kartë elektronike i referohet VKM Nr. 5611 date 29.07.2016 “Per standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburanteve në njësitë e qeverisjes vendore”.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

V. Pili

Të dhënat teknike të Gazoil D1 i referohen standardit evropian (EN) të adoptuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit dhe që ka statusin e standardit shqiptar (S SH):
Specifikimet teknike sipas S SH EN 590:2013 + A1 : 2017

Kërkesa të përgjithshme të zbatueshme dhe metodat e testimit

Treguesit	Njësia e matjes	Kufijtë		Metoda e testimit Ne perputhje me
		Minimum	Maksimum	
Numri i cetanit ^b		51,0	-	EN ISO 5165 ASTM D 613
Indeksi i cetanit		46,0	-	S SH EN ISO 4264 ASTM D 976
Densiteti në 15 °C ^c	kg/m³	820,0	845,0	ASTM D 7777
Hidrokarburët aromatikë policiklikë^{d,e}	% (m/m)	-	8,0	ASTM D 5186
Përmbajtja e squfurit ^f	mg/kg	-	10,0	EN ISO 20846
Pika e flakërimit	°C	55	-	EN ISO 2719 ASTM D 93
Përmbajtja e koksit ^g (në 10 % mbetje distilimi)	% (m/m)	-	0,30	EN ISO 10370
Përmbajtja e hirit	% (m/m)	-	0,01	EN 6245
Pika e bllokimit të filtrit në te ftohte CFPP⁺	°C			EN 116
Korrozioni i shufrës së bakrit (3 orë në 50 °C)	vlerësim	klasa 1		EN ISO 2160
Përmbajtja e esterit metilik te acidit yndyror (FAME)	% v/v		7,0	EN 14078 D 7806
Viskoziteti në 40 °C	mm²/s	2,00	4,50	EN ISO 3104
Përmbajtja e ujit	mg/kg		200	EN ISO 12937

Lubriciteti, diametri i korektuar i gervishtjes	μm		460	EN ISO 12156-1
Ndotja e Pergjitheshme	mg/kg		24	EN 12662
Stabiliteti ndaj oksidimit	g/m ³		25	EN ISO 12205
Distilimi :				
Distilati që vlon deri në 250°C, %(v/v)	% v/v		65	EN ISO 3405 ASTM D 86
Distilati që vlon deri në 350 °C, %(v/v)		85		
95 % (v/v) distilon në	°C		360	

Në momentin e dorëzimit të mallit fituesi duhet të paraqesë certifikatën e origjinës e cila vërteton që malli i importuar është nga vendet e komunitetit europian.

V.Pili

Në realizimin e kontratës që do të lidhet me fituesin, në furnizimet që do të kryhen, çdo sasi gazoili duhet të shoqërohet me dokumentin raport analizimi në tregun e brendëshëm, të gazoilit, lëshuar nga Organet e Miratuara te Vleresimit te Konformitetit/ Inspektoriati Shtetëror Teknik, Drejtoria e Laboratorit Qëndror të Kontrollit, të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre.

UKRK gjithashtu do të bëjë testime ose inspektime shtesë të gjykuara të nevojshme për të verifikuar se gazoili është konform specifikimeve dhe kushteve teknike të kërkuara. UKRK do të mbajë përgjegjësi për koston e këtyre testimeve. Konkretisht UKRK, për çdo furnizim, do të kryejë analizimin e gazoilit tek Laboratori Shtetëror i Kontrollit i ISHTI Tiranë/ Organet e Miratuara te Vleresimit te Konformitetit.

UKRK me cilesinë e blerësit ka te drejtë dhe mund te kryejë verifikimin e sasisë të gazoilit, në prani të furnizuesit, me metodën e peshimit, pesha bosh dhe pesha plot dhe konvertimi në litra do të bëhet në bazë të densitetit të gazoilit.

Blerësi UKRK do të refuzojë çdo sasi gazoili që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është konform specifikimeve teknike dhe kushteve të kërkuara në zbatimin e kontratës.

Sasia e mallit që kërkohet: 25000 litra Gazoil D1

Afatet e lëvrimit: Afati i lëvrimit do të jetë deri me 31.12.2025, duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës. Lëvrimi do të kryhet periodikisht sipas kërkesës të Autoritetit Kontraktor UKRK Sh.A, nëpërmjet autobotit tek depozita e UKRK, nëpërmjet kartave elektronike në piken e shitjes në çdo moment të paraqitjes së punonjesit duke paraqitur kartën elektronike si dhe/ose nëpërmjet tollonave.

Vaso Pili (Inxhinier kimist)

LOTI II- Benzine

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4, me vlere 12.997 (dymbëdhjetë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë) leke (2% të vlerës së përllogaritur të kontratës per lotin e dyte);

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, te ndryshuar nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

L.Duka

V.Pili

E.Bicolli

Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023, 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vleres së parashikuar në kontratë për secilin nga lotet, pra jo më e vogël se 259.940 (dyqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e nëntë qind e dyzet) Lekë për lotin e dyte blerje Benzine.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet bazuar në dispozitat e siperpermendura, ku përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopjeve të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe sipas rastit të xhiros që mbulon kontratë, për një periudhë maksimumi deri në 3(tre) vitet e fundit financiare. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatoreve ekonomike nuk mund të tejkalojë: (c) 40% të vleres së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar si dhe siapër parashikimit të nenit 55 të Rregullave të PP”.

“Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor”.

Kërkesa e mësipërme është në përputhje dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës. Ajo i shërben UKRK sh.a për njohjen e gjendjes financiare të operatoreve ekonomike dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Vlera e xhiros që kërkohej është në përputhje me vlerën e përcaktuar në nenin 43 pika 2.c të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Gjithashtu vlera e kërkuar bazohet në nenin 42 pika 3 të VKM Nr. 285 ku përcaktohet se: “Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përputhje dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, ku përcaktohet: “Cdo tatimpagues për gatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës”.

L.Duka

V.Pili

E.Bicolli

3. Aftësitë teknike dhe profesionale:

3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të

vogël se 129.970 (njëqind e njëzet e nëntë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë) Leke pa TVSH (20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate per lotin e dyte).

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- c) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- d) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe neni 40, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 55, pika 4, b ku përcaktohet shprehimisht, citojmë:

“ Për kontratat e mallrave vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. ”

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën si më sipër, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar (20% e vlerës per lotin e dyte).

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor UKRK SH.A., për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvojave të duhura, që janë në përpjesëtim me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës siç është parashikuar nga AK.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

V.Pili

3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme profesionale për Tregtimin me Pakicë të Karburanteve, Gazit të Lëngshëm të Naftës, për Automjetet, Vajrave Lubrifikante dhe Lëndëve Djegëse për përdorim nga Konsumatorët Fundorë, për gazoilin e per benzinen e kërkuar, lëshuar nga Organi i Qeverisjes Vendore.

(shënim-përcaktoni, nëse parashikohet nga legjislacioni në fuqi, llojin e licencës së nevojshme që lidhet me objektin e prokurimit, si dhe institucionin që lëshon licencën e kërkuar).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, neni 40, pika 5, gërma a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, si dhe ligjin Nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me ligjin Nr. 71/2014, nenin 14, pika 7, që përcakton se: “Shoqëritë e tregtimit

me shumicë kane te drejte të furnizojnë, sipas kushteve të licencës përkatëse, rafineritë e naftës, impiantet e përpunimit, shoqëritë e tregtimit me pakicë, të pajisura me licencë tregtimi, mjetet detare dhe ajrore, si dhe konsumatorët e mëdhenj.”, si dhe neni 1/1, pikat 11, 12, 14,15, përcakton se:

”11. “Shoqëri tregtimi me shumicë” është personi juridik që blen naftë dhe nënproduktet e saj me qëllim shitjeje tek të tretët.

12. “Shoqëri tregtimi me pakicë” është personi juridik që blen nënprodukte të naftës, me qëllim shitjeje te personat, që janë konsumatore fundore.

14. “Konsumatorë të mëdhenj” janë personat juridikë që konsumojnë për nevojat e veta nënproduktet e naftës në një sasi jo më pak se 50 m³ në muaj dhe që posedojnë instalime depozitimi të këtyre produkteve.

15. “Konsumator fundor” është personi fizik apo juridik që blen produktet e gatshme për nevojat e veta.”,

Bazuar në këtë ligj, Operatorët ekonomikë duhet të paraqisin Leje (Autorizim) profesionale të tregtimit me pakicë të karburanteve, sepse vetëm leja profesionale e tregtimit me pakicë i jep atyre të drejtën ligjore për të furnizuar UKRK, si një konsumator fundor.

Bazuar në këtë ligj, Operatorët ekonomikë duhet të paraqisin Leje (Autorizim) profesionale të tregtimit me pakicë të karburanteve, sepse vetëm leja profesionale e tregtimit me pakicë i jep atyre të drejtën ligjore për të furnizuar UKRK, si një konsumator fundor.

VKM Nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” të ndryshuar, Kreu II, pika 1 që përcakton:

1. Dhënia e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, e vajrave lubrifikante dhe të njësive të lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, bëhet nga:

a) Ministri që mbulon veprimtarinë e transportit rrugor, kur stacioni i karburanteve do të ndërtohet në autostradë;

b) Organet e qeverisjes vendore, sipas juridiksionit përkatës, në rastet kur stacionet e shitjes së karburanteve, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të karburanteve për automjete, gazit të lëngshëm e vajrave lubrifikante dhe të njësive të shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, do të ndërtohen në territoret e tjera.”

(shënim- përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse të furnizimit, ose nëse është rasti të prodhimit të mallrave objekt prokurimi, që lidhet me objektin e kontratës së prokuruar).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

V. Pili

3.3. Raport testimi, për cilësinë e gazoil, në përputhje me specifikimet teknike të DT, lëshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit/ Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI).

Argumentim: Ky kriter është vendosur nga ana e AK në zbatim të kërkesave që përcakton ligji nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ligji Nr. 8450, datë 24.02.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar,

VKM Nr.147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzene dhe diesel” si dhe VKM Nr. 491, date 19.07.2017 “Per percaktimin e rregullave, te kushteve teknike dhe normave te mirembajtjes se instalimeve nen presion, qe sherbejne per perpunimin, transportimin, depozitimin dhe tregtimin e naftes, te gazit dhe nenprodukteve te tyre”, kreu V.

Plotësimi i këtij kriteri garanton ekzekutimin e objektit të kontratës në përputhje me specifikimet teknike të DT.

3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga Organet e Miratuara të Vleresimit të Konformitetit/ISHTI, që subjekti ka tregtuar karburante sipas standarteve të legjislacionit shqiptar dhe nuk ka patur penalitete për shkelje të cilësisë të karburantit për vitin 2024.

Argumentim: Ky kriter është vendosur nga ana e AK në zbatim të kërkesave që përcakton ligji nr.8450, datë 24.02.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM Nr. 970, datë 2.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënie e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” të ndryshuar, VKM Nr.147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzine dhe diesel”.

Plotësimi i këtij kriteri garanton zbatimin e kontratës gjatë periudhës së zbatimit duke treguar që OE ofertues në aktivitetin e tij zbaton rregullat dhe ligjet në fuqi.

3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të dorëzojë një deklaratë/listë të stacioneve të shitjes (shpërndarjes) të benzines, me adresat e tyre, e cila të vërtetojë që ofertuesi të ketë stacione shitje në rajonin ku ushtron veprimtarinë e saj Shoqëria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Korçë Sh.a (në Korçë, aksin Korçë - Ersekë, në aksin Korçë – Bilisht dhe në aksin Korçë - Maliq) si dhe në aksin Korçë - Tiranë.

Argumentim: Në bazë të nenit 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që disponojnë stacione të shitjes të benzines në akset si me sipër.

Disponimi i stacioneve të tregtimit të karburantit në akset si me sipër përmendur kërkohet për shkak se Korça, Erseka, Bilishti e Maliqi janë vendet e ushtrimit të aktivitetit të AK Shoqërisë Rajonale Ujesjellës Kanalizime Korçë Sh.A .

Disponimi i stacioneve të tregtimit të karburantit në aksin Korçë - Tiranë kërkohet për shkak se punonjësit e AK kryejnë në Tiranë, lëvizje me automjete për arsye pune, si takime, mbledhje, seminare, trajnime etj, me ditë qëndrimi më shumë se një ditë dhe mund të lindë nevoja për furnizim me karburant me kartën elektronike, në stacionet e tregtimit të karburantit.

V.Pili

3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë marrjen përsipër të furnizimit me karta elektronike sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor .

Argumentim: Në bazë të nenit të 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar neni 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që disponojnë stacionet e shitjes të gazoilit të kërkuara si dhe mund të kryejnë furnizimin me karta elektronike, për të përmbushur kontratën, të nevojshme këto për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Konvertimi i sasisë së litrave me kartë elektronike i referohet VKM Nr. 5611 date 29.07.2016 “Per standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburanteve në njësitë e qeverisjes vendore”.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

V. Pili

Të dhënat teknike të Benzinë Premium Unl ppm i referohen standardit evropian (EN) të adoptuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit dhe që ka statusin e standardit shqiptar (S SH):

Specifikimet teknike sipas S SH EN 590:2013

Benzinë Premium Unl ppm në përputhje me standardin shtetëror S SH EN 228:2012+A1:2017

Nr.	Treguesit	Njësia e matjes	Kufijtë e lejuar	
1	Numri Oktanit Kerkimor		95	
2	Numri i Oktanit Motorrik		85	
3	Densiteti në 15 °C	Kg/m ³	720	775
4	Përmbajtja e Sqfurit	mg/kg		10
5	Korrozioni i shufrës së bakrit (3 orë/50 °C)	Renditje	Klasa 1	
6	Pamja e jashtme		E pastër dhe e tejdukshme	
7	Distilimi			
a	Distilon deri 70 °C	% (v/v)	20	48
b	Distilon deri 100 °C	% (v/v)	46	71
c	Distilon deri 150 °C	% (v/v)	75	-
d	Pika Finale e Distilimit	°C	-	210
e	Mbetjet e Distilimit	% (v/v)	-	2
8	Përmbajtja e tipit të hidrokarburit			
a	Olefinat	% (v/v)	-	18
b	Aromatiket	% (v/v)	-	35
9	Përmbajtja e benzenit	% (v/v)	-	1
10	Përmbajtja e oksigjenit	% (m/m)	-	2.7
11	Përmbajtja e komponimeve oksigjenore			
a	Methanol (alkool metilik)	% (v/v)		3
b	Etanol (alkool etilik)			5
c	- Alkool izopropilik		Përzierja në vëllim i kufizuar në 2.7% (m/m) të përmbajtjes maksimale të oksigjenit	
	- Alkool izo butilik			
	- Alkool terc butil			
	- Etere (me 5 ose më shumë atome C)			
	- Komponime oksigjenore të tjera			

Në momentin e dorëzimit të mallit fituesi duhet të paraqesë certifikatën e origjinës e cila vërteton që malli i importuar është nga vendet e komunitetit evropian.

Në realizimin e kontratës që do të lidhet me fituesin, në furnizimet që do të kryhen, çdo sasi benzine duhet të shoqërohet me dokumentin raport analizimi në tregun e brendëshëm, të benzines, lëshuar nga Organet e Miratuara te Vleresimit te Konformitetit/ Inspektoriati Shtetëror Teknik, Drejtoria e Laboratorit Qëndror të Kontrollit, të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre.

UKRK gjithashtu do të bëjë testime ose inspektime shtesë të gjykuara të nevojshme për të verifikuar se benzina është konform specifikimeve dhe kushteve teknike të kërkuara. UKRK do të mbajë përgjegjësi për koston e këtyre testimeve. Konkretisht UKRK, për çdo furnizim, do të kryejë analizimin e benzines tek Organet e Miratuara te Vleresimit te Konformitetit/ Laboratori Shtetëror i Kontrollit i ISHTI Tiranë, apo tek Organet e Miratuara te Vleresimit te Konformitetit.

UKRK me cilesinë e blerësit ka të drejtë dhe mund të kryejë verifikimin e sasisë të benzines, në prani të furnizuesit, me metodën e peshimit, pesha bosh dhe pesha plot dhe konvertimi në litra do të bëhet në bazë të densitetit të benzines.

Blerësi UKRK do të refuzojë çdo sasi benzine që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është konform specifikimeve teknike dhe kushteve të kërkuara në zbatimin e kontratës.

V.Pili

Sasia e mallit që kërkohet: 5000 litra Benzine

Afatet e lëvrimit: Afati i lëvrimit do të jetë deri me 31.12.2025, duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës. Lëvrimi do të kryhet periodikisht sipas kërkesës të Autoritetit Kontraktor UKRK Sh.A, nëpërmjet autobotit tek depozita e UKRK, nëpërmjet kartave elektronike në piken e shitjes në çdo moment të paraqitjes së punonjesit duke paraqitur kartën elektronike si dhe/ose nëpërmjet tollonave.

Njësia e prokurimit

Levita Duka (Person Përgjegjës) Vaso Pili (Inxhinier kimist) Eluela Bicolli (Ekonomist)